

## Për të gjithë ata që u është thënë të qëndrojnë në karantinë ose në izolim shtëpiak

Shumica e njerëzve të cilët zhvillojnë sëmundjen koronavirus (COVID-19) ndjejnë simptoma të lehta, por disa të tjerë mund të sëmuren rëndë. Për këtë arsyeja pse ne po përpiqemi të ngadalësojmë përhapjen e infeksionit në të gjithë vendin. Disave u është kërkuar nga mjeku të qëndrojnë në shtëpi.

- Kushdo që është diagnostikuar me COVID-19 duhet të izolohet plotësisht nga njerëzit e tjerë përmes të ashtuquajturit "izolim shtëpiak".
- Kushdo që nuk është diagnostikuar me COVID-19, por mund të jetë ekspozuar ndaj infeksionit, duhet të vendoset në "karantinë".
- Personat që mbërrin në Norvegji nga shumë vende të tjera duhet gjithashtu të hyjnë në "karantinë".

Çka do të thotë "izolim shtëpiak"?

Nëse mjeku ju ka thënë se keni COVID-19 ose nëse jeni në pritje të rezultatit të testit tuaj, duhet t'i shmangni të gjitha kontaktet me njerëzit e tjerë në mënyrë që të mos infektoni të tjerët.

Izolimi shtëpiak nënkupton se ju duhet të izoloheni nga të gjithë, përfshirë edhe njerëzit me të cilët jetoni. Ju nuk duhet të dilni jashtë, duhet të qëndroni dhe të hani vetëm në dhomë, si dhe të mos i ndani peshqirët me të tjerët.

Nëse gjendja ju përkeqësohet, kontaktoni mjekun me telefon në numrin 116 117. Mjeku gjithashtu mund të marrë vendimin se ju duhet të izoloheni në spital. Izolimi zgjat derisa mjeku t'ju thotë se nuk keni infeksion ose derisa rezultati juaj i testit të tregojë se nuk keni më COVID-19.

Çka do të thotë "karantinë"?

Nëse mjeku ju ka thënë se nuk jeni i sëmurë, por keni qenë të ekspozuar ndaj infeksionit, duhet të qëndroni në karantinë. E njëjta gjë aplikohet edhe nëse mbërrini në Norvegji nga shumë vende të tjera. Ju duhet të qëndroni në shtëpi ose në një vend tjetër të përshtatshëm, por karantina shtëpiake nuk është aq e rreptë sa izolimi shtëpiak.

Karantina nënkupton se ju duhet të zvogëloni kontaktin me njerëzit e tjerë sa më shumë që të jetë e mundur, por nuk keni pse të izoloheni plotësisht. Ju nuk duhet të shkoni në shkollë ose punë, ose të bëni ndonjë aktivitet tjetër. Ju nuk duhet të udhëtoni me transport publik (autobus, tramvaj, metro, tren, transport ajror ose traget), por mund të shkoni në shëtitje vetëm.

Informasjon til deg som har fått beskjed om å holde deg hjemme

Språk: Albanian/Shqip

Opprettet: 03/2020 Oppdatert: 16.06.20



Norwegian Institute of Public Health

Nëse filloni të kolliteni, keni infeksion në fyt ose ethe apo keni vështirësi në frymëmarrje, është e rëndësishme që të kontaktoni mjekun me telefon në numrin 116 117. Testi për COVID-19 është falas në Norvegji.

Karantina zgjat 10 ditë pas mbërritjes suaj në Norvegji ose ekspozimit më të fundit ndaj infeksionit.

Vazhdoni të jeni të informuar!

Qeveria u kërkon të gjithëve në Norvegji të lexojnë informacionin dhe këshillat e rëndësishme në lidhje me koronavirusin në [www.fhi.no](http://www.fhi.no) dhe [www.helsenorge.no](http://www.helsenorge.no). Këto këshilla mund të ndryshojnë. Informacioni është në dispozicion si në norvegjisht ashtu edhe në anglisht. Nëse e keni të vështirë të kuptoni, ju lutemi kërkon ndihmë nga dikush që njihni.